



BASHKIA MALIQ



Plani Arsimit Parauniversitar 2026 - 2028

Përmbajtja

1.	Hyrje dhe konteksti.....	7
	Konteksti administrativ	7
	Të dhëna demografike	7
	Struktura e popullsisë së re nw moshw	8
	Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	9
2.	Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	11
	Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve	11
	Frekuentimi	11
	Shërbimi i vakteve ushqimore në arsimin parashkollor	13
3.	Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit	13
	Frekuentimi sipas niveleve arsimore	14
	Frekuentimi në arsimin fillor	14
	Frekuentimi në arsimin 9-vjeçar	15
	Frekuentimi në arsimin e mesëm	16
4.	Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative	16
	Njësia Administrative Maliq	16
	Njësia Administrative Libonik	17
	Njësia Administrative Gorë.....	18
	Njësia Administrative Moglicë	18
	Njësia Administrative Vreshtas.....	19
	Njësia Administrative Pirg	19
	Njësia Administrative Pojan.....	20
5.	Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse	21
	Analiza e burimeve njerëzore edukative në Arsimin Parashkollor	21
	Burimet njerëzore mbështetëse për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm	21
6.	Vizioni	22
7.	Qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	23
8.	Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	24
	Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor	24
9.	Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	26
10.	Plani i investimeve kapitale	41
	Monitorimi dhe vlerësimi	42
	Treguesit e performancës	42
	Planifikimi i vlerësimit të progresit.....	42
	Përfshirja e aktorëve të jashtëm	42
	Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	42
	Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	42

Vlerësimi i ndikimit në komunitet	43
11. Rishikimi dhe përshtatja e planit	43
Procesi i rishikimit	43
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	44
12. Raportimi dhe transparenca	44
13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	45

Parathënie

Bashkia Maliq, me përkushtim ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të arsimit, ka hartuar këtë Plan Strategjik për Arsimin Parauniversitar, i cili përfshin arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Ky plan është fryt i një pune të koordinuar ndërmjet strukturave vendore, institucioneve arsimore, komunitetit dhe partnerëve zhvillimorë, me synimin për të garantuar që çdo fëmijë dhe nxënës të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar në mjedise të sigurta, me kushte të mira dhe mbështetje të plotë nga shkolla, familja dhe komuniteti.

Qëllimi ynë kryesor është sigurimi i një sistemi arsimor cilësor dhe të aksesueshëm, që garanton mirëqenie, zhvillim dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Në këtë kuadër, janë përcaktuar tre shtylla kryesore veprimi:

- Garancia e funksionimit të qëndrueshëm dhe cilësor të institucioneve arsimore duke siguruar mbulim të plotë me staf arsimor e staf mbështetës, infrastrukturë të përshtatshme, kushte higjieno-sanitare, sisteme të ngrohjes dhe furnizime të nevojshme për të gjitha 43 kopshtet dhe 48 shkollat në territorin e bashkisë.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimit përmes ndërtimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit të të paktën 3 institucioneve arsimore deri në vitin 2028, si dhe krijimit të një regjistri digjital të të dhënave për institucionet arsimore me përditësim të rregullt.
- Fuqizimi i edukimit parashkollor dhe përfshirjes sociale duke zhvilluar programe trajnimi të vazhdueshëm për edukatorët dhe stafin mbështetës, ofruar shërbime psiko-sociale, përforcuar strukturat pjesëmarrëse dhe krijuar mundësi për të gjithë fëmijët, përfshirë ata nga familjet në nevojë dhe ata me rezultate të larta.

Ky plan përfshin gjithashtu investime të rëndësishme kapitale për përmirësimin e mjediseve mësimore, pajisjet, forcimin e sigurisë në shkolla dhe zgjerimin e programeve jashtëshkollore kulturore e sportive, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe të rinjve.

Dokumenti shërben si udhërrëfyes për zhvillimin e arsimit në Bashkinë Maliq deri në vitin 2028, duke u bazuar në parimin se një investim në arsim është një investim në të ardhmen. Ai synon të sigurojë që çdo hap i ndërmarrë sot të ndërtojë një të ardhme më të sigurt, më të barabartë dhe më të pasur për brezat që vijnë.

Falënderime

Bashkia Maliq shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Maliqit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Maliq.

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Maliq është një njësi e rëndësishme e qeverisjes vendore në qarkun e Korçës, e krijuar pas reformës administrative të vitit 2015. Ajo përfshin shtatë njësi administrative: **Maliq, Libonik, Gorë, Moglicë, Vreshtas, Pirc dhe Pojan**. Këto njësi përfaqësojnë një ndërthurje të zonave urbane dhe rurale, ku qyteti i Maliqit shërben si qendra kryesore urbane, ndërsa pjesa tjetër e territorit përbëhet nga fshatra të shtrira në zona fushore e malore.

Me një sipërfaqe prej rreth **656 km²** dhe një popullsi prej afërsisht **61 mijë banorësh** (sipas Gjendjes Civile), Bashkia Maliq ka njohur një rënie të dukshme demografike krahasuar me vitin 2011. Ky ndryshim ndikon drejtpërdrejt në planifikimin e shërbimeve publike, përfshirë arsimin parashkollor, si dhe në mënyrën e organizimit të rrjetit të institucioneve arsimore.

Diversiteti gjeografik i bashkisë, nga fushat pjellore të Libonikut e Pojanit deri te zonat e thella malore të Moglicës e Gorës, kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve. Zonat urbane kanë një përqendrim më të madh të popullsisë dhe të infrastrukturës, ndërsa zonat rurale e malore përballen më shpesh me sfida të lidhura me distancat, transportin, mungesën e stafit dhe aksesin në shërbime të barabarta.

Struktura e fragmentuar territoriale e Bashkisë Maliq bën që njësitë administrative të mbeten pika kyçe për ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar dhe parashkollor. Kjo kërkon koordinim të ngushtë ndërmjet qendrës bashkiake dhe njësive administrative për të garantuar cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin.

Në këtë kuadër, planifikimi i arsimit parashkollor në Bashkinë Maliq do të marrë parasysh jo vetëm shpërndarjen gjeografike dhe demografike të popullsisë, por edhe nevojën për optimizimin e burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që çdo fëmijë, pavarësisht nëse jeton në qytet apo në një fshat të largët malor, të ketë të njëjtin nivel mundësish dhe cilësi shërbimi.

Të dhëna kryesore:

- **Qendra e bashkisë:** Qyteti i Maliqit
- **Sipërfaqja:** 656 km²
- **Popullsia:** **61,601** banorë (Gjendja Civile)
- **Dendësia:** rreth 47 banorë/km²
- **Njësitë administrative:** 7 Njësi – Maliq, Libonik, Gorë, Moglicë, Vreshtas, Pirc, Pojan
- **Fshatra:** **72 fshatra të banuar**

Të dhëna demografike

Struktura e popullsisë përfshin një përqindje të konsiderueshme të fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve edukative për këto kategori.

Sipas të dhënave nga Gjendja Civile, popullsia e regjistruar është dukshëm më e lartë **61,601 banorë**, prej të cilëve **31,557 meshkuj dhe 30,044 femra**, diferencë që shpjegohet me emigracionin dhe lëvizjen e popullsisë, e cila ndikon në kërkesën reale për shërbime publike.

Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative dhe gjinisë është si më poshtë:

Njësia Administrative	Femra	Meshkuj	Totali
Maliq	3 780	3 815	7 595
Libonik	6 683	6 959	13 642
Gorë	1 063	1 217	2 280
Moglicë	462	588	1 050
Vreshtas	5 048	5 400	10 448
Pirg	4 835	5 186	10 021
Pojan	8 117	8 548	16 665
Totali	30 044	31 557	61 601

Kjo shpërndarje tregon dallime të dukshme në madhësinë e popullsisë midis njësive administrative. Pojani dhe Liboniku kanë numrin më të lartë të banorëve, ndërsa Moglica dhe Gorë janë njësitë më pak të populluara.

Struktura e popullsisë së re në moshë

Të dhënat e fundit të **Censusit 2023** për shpërndarjen e popullsisë sipas grupmoshave tregojnë se Bashkia Maliq ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh dhe të rinjsh, duke e bërë këtë grup një përparësi në planifikimin e shërbimeve arsimore dhe sociale.

Grupmosha	Numri i banorëve
0–4 vjeç	1 146
5–9 vjeç	1 448
10–14 vjeç	1 749
15–19 vjeç	1 791

Nga analiza del se:

- **Fëmijët në moshë parashkollore (0–4 vjeç)** përbëjnë një bazë të rëndësishme për shërbimet e edukimit të hershëm. Kjo grupmoshë përfaqëson potencialin kryesor për rritjen e kërkesës ndaj kopshteve dhe programeve të zhvillimit të hershëm.
- **Fëmijët e ciklit fillor (5–9 vjeç)** dhe **nxënësit e ciklit të ulët (10–14 vjeç)** përbëjnë grupet më të mëdha në arsimin bazë, çka kërkon kapacitete të mjaftueshme në infrastrukturë dhe staf mësimor.
- **Të rinjtë 15–19 vjeç** janë grupmosha më e madhe në përfaqësim brenda të rinjve, duke reflektuar nevojën për investime në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional, si dhe për politika që mbështesin përgatitjen për tregun e punës ose studimet e larta.

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Maliq në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Maliq udhëhiqet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikatat lokale në territorin e Bashkisë Maliq.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Maliq vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën

Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025


Shpërndarja dhe ofrimi i shërbimit të kopshteve

Në Bashkinë Maliq, struktura demografike tregon një prani të konsiderueshme të fëmijëve dhe të rinjve, gjë që e bën arsimin parashkollor dhe parauniversitar një prioritet thelbësor në planifikimin e shërbimeve publike. Vetëm grupmosha 0–4 vjeç përfshin 1 146 fëmijë, që përfaqësojnë potencialin kryesor të përfshirjes në edukimin e hershëm.

Për t’iu përgjigjur kësaj strukture demografike, në Bashkinë Maliq funksionojnë **43 kopshte** të shpërndara si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale. Kjo shpërndarje gjeografike synon të garantojë akses të barabartë në edukimin parashkollor, duke minimizuar pabarazitë territoriale.

Numri i kopshteve sipas njësive administrative është si më poshtë:

Njësia Administrative	Nr. i Kopshteve
Libonik	7
Vreshtas	5
Pirg	10
Gorë	5
Pojan	10
Maliq	3
Moglicë	3
Totali	43



Kjo shpërndarje tregon se njësitë me popullsi më të madhe si Pojani, Pirgu dhe Liboniku kanë gjithashtu një përqendrim më të lartë institucionesh parashkollore, ndërsa njësitë më të vogla si Moglica dhe Maliqi kanë numër më të kufizuar, por të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat lokale. Strategjia e mbulimit gjeografik të kopshteve reflekton një përpjekje të qartë për të siguruar qasje sa më të afërt dhe të barabartë për çdo fëmijë në territorin e bashkisë.

Frekuentimi

Në Bashkinë Maliq, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç është **838**, prej të cilëve **426** janë djem dhe **412** janë vajza. Nga ky numër, **787** fëmijë ndjekin kopshtin, që përfaqëson një përfshirje të përgjithshme prej **93.91%** në arsimin parashkollor.

Analiza sipas gjinisë tregon se:

- **99.06%** e djemve të moshës 3–6 vjeç janë të përfshirë në edukimin parashkollor (422 nga 426 djem),
- **88.59%** e vajzave të moshës 3–6 vjeç ndjekin kopshtin (365 nga 412 vajza).

Të dhënat tregojnë se frekuentimi është shumë i lartë në krahasim me mesataren kombëtare, por gjithsesi kërkohet vëmendje për të rritur përfshirjen e vajzave në mënyrë që të arrihet barazia gjinore në këtë nivel arsimor.

Analiza e të dhënave mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Bashkinë Maliq tregon një shpërndarje të ndryshme të frekuentimit midis njësive administrative, e cila lidhet ngushtë me madhësinë e popullsisë dhe përqendrimin e infrastrukturës arsimore.

Njësia Administrative	Nr. i fëmijëve gjithsej	Vajza	Djem
Gorë	29	16	13
Libonik	126	55	71
Maliq	101	57	44
Moglicë	14	7	7
Pirg	155	69	86
Pojan	227	97	130
Vreshtas	135	64	71
Totali	787	365	422

- Pojani ka numrin më të lartë të fëmijëve që ndjekin kopshtin (227), pasuar nga Pirg (155) dhe Vreshtas (135).
- Moglica ka numrin më të ulët të frekuentuesve (14 fëmijë), çka mund të lidhet me dendësinë e ulët të popullsisë dhe distancat gjeografike.
- Në shumicën e njësive, numri i djemve që ndjekin kopshtin është pak më i lartë se ai i vajzave, përjashtuar Maliqin, ku vajzat janë më të shumta.

Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e zonave ku mund të nevojiten ndërhyrje specifike për të rritur përfshirjen, përmirësuar infrastrukturën ose lehtësuar aksesin, veçanërisht në njësitë me popullsi të shpërndarë dhe të largët.

Shërbimi i vakteve ushqimore në arsimin parashkollor

Aktualisht, në territorin e Bashkisë Maliq nuk ofrohet shërbimi i vakteve ushqimore në asnjë prej kopshteve. Ky është një nga objektivat që synohet të realizohet gjatë periudhës afatmesme, duke filluar me një projekt pilot në Kopshtin “Reze Drite” në qytetin e Maliqit. Ky institucion, i rikonstruktuar kohët e fundit, disponon hapësirën dhe kushtet e nevojshme për të zgjeruar shërbimin me ushqim të gatuar në vend.

Plani parashikon që brenda tre viteve të ardhshme të realizohen:

- Blerja e pajisjeve të nevojshme për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit;
- Rekrutimi i personelit të dedikuar për kuzhinën dhe shërbimin ushqimor;
- Zgjatja e kohës së qëndrimit të fëmijëve në kopsht, duke i mundësuar një regjim të plotë ushqimor dhe orar të zgjeruar edukativ.

Ky shërbim pritet të ketë ndikim pozitiv jo vetëm në mirëqenien e fëmijëve, por edhe në rritjen e mundësive të punësimit për nënat, pasi zgjerimi i orarit të qëndrimit në kopsht u krijon atyre më shumë hapësirë kohore për t'u angazhuar në tregun e punës. Në këtë mënyrë, Bashkia Maliq synon të forcojë lidhjen mes shërbimeve arsimore, zhvillimit social dhe mbështetjes së familjeve.

3. Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Rrjeti arsimor në territorin e Bashkisë Maliq është ndërtuar dhe organizuar në mënyrë që të mbulojë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit lokal, duke garantuar akses të barabartë për fëmijët dhe të rinjtë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.


Shkollat fillore – gjithsej **18** institucione – ofrojnë edukimin bazë për fëmijët në fazat e para të formimit, duke u fokusuar në shkrim, lexim, matematikë dhe njohuri të tjera themelore. Vendorsja e tyre është menduar në mënyrë që të jenë sa më pranë vendbanimeve, për të lehtësuar aksesin e nxënësve të vegjël dhe për të shmangur distancat e gjata të udhëtimit.

Shkollat 9-vjeçare, gjithsej **29** institucione, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët. Ato ofrojnë një arsim të plotë bazë dhe shërbejnë si pika kyçe për zhvillimin akademik dhe social të nxënësve, duke i përgatitur ata për arsimin e mesëm. Shtrirja e këtyre shkollave në zona të ndryshme të bashkisë synon të reduktojë pabarazitë në akses dhe cilësi shërbimi.

Shkollat e mesme, gjithsej **7** institucione, përfshijnë gjimnazet dhe shkollat e tjera të përgjithshme, të cilat synojnë përgatitjen e të rinjve për studime të mëtejshme universitare ose për hyrjen në tregun e punës. Këto shkolla janë vendosur në pika strategjike të territorit për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme, duke lehtësuar transportin dhe aksesin.

Shpërndarja e shkollave sipas njësive administrative është si më poshtë:

Shpërndarja e shkollave sipas njësive administrative në Bashkinë Maliq



Njësia Administrative	Nr. i shkollave
Gorë	9
Libonik	7
Maliq	4
Moglicë	5
Pirq	9
Pojan	10
Vreshtas	4
Totali	48

Frekuentimi sipas **shkollave** arsimore

Frekuentimi në **shkollat e arsimit** fillor

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin fillor	Përqindja (%)
Djem	98	48.51
Vajza	104	51.49

Sipas të dhënave më të fundit, në shkollat fillore të Bashkisë Maliq janë regjistruar gjithsej 202 nxënës, prej të cilëve 98 janë djem (48.51%) dhe 104 janë vajza (51.49%). Kjo ndarje tregon një balancë të mirë gjinore në përfshirje, me një diferencë të lehtë në favor të vajzave.

Frekuentimi ndryshon në varësi të njësive administrative dhe shkollave, duke reflektuar ndikimin e faktorëve lokalë si:

- përqendrimi dhe shpërndarja e popullsisë,
- gjendja e infrastrukturës shkollore,
- distancat dhe/ose mundësitë e transportit,
- kushtet socio-ekonomike të familjeve,
- ndërgjegjësimi dhe kultura komunitare ndaj arsimit.

Shpërndarja e nxënësve **në shkolla** sipas njësive administrative:

- Pìrg ka numrin më të madh të nxënësve në shkollat e arsimit fillor (75 nxënës gjithsej), pasuar nga Libonik (63 nxënës) dhe Pojan (43 nxënës).
- Gorë ka numrin më të ulët të nxënësve (7 nxënës), çka lidhet me dendësinë e ulët të popullsisë dhe karakterin e shpërndarë të vendbanimeve.
- Maliq ka 14 nxënës në një shkollë fillore, ndërsa Pojani ka disa institucione me numër të moderuar nxënësish.
- Në shumicën e shkollave, raporti vajza–djem është relativisht i balancuar.
- Disa shkolla kanë numër shumë të ulët nxënësish (1–2 nxënës), si p.sh. Lozhan Fshat në Gorë, çka tregon sfida për eficiencën e shërbimit dhe nevojën për rishikimin e strukturës së rrjetit shkollor.
- Numri më i lartë i nxënësve për një shkollë fillore raportohet në **Velitërnë (Pìrg)** me 28 nxënës dhe **Leminot (Pìrg)** me 24 nxënës.

Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e planifikimit të diferencuar të arsimit fillor në Bashkinë Maliq, për të garantuar jo vetëm mbulim territorial, por edhe cilësi dhe eficiencë në ofrimin e shërbimit. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore, ofrimi i transportit aty ku është i nevojshëm dhe mbështetja për zonat me dendësi të ulët të popullsisë do të jenë hapa të rëndësishëm për rritjen e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në këtë nivel arsimor.

Frekuentimi në shkollat e arsimit 9-vjeçar

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin 9-vjeçar	Përqindja (%)
Djem	1 352	50,71
Vajza	1 315	49,29

Sipas të dhënave të fundit, në shkollat 9-vjeçare të Bashkisë Maliq janë regjistruar gjithsej 2 667 nxënës, prej të cilëve 1 352 janë djem 50,71 (%) dhe 1 315 janë vajza (49,29%). Rrjeti përbëhet nga 29 shkolla, nga të cilat 6 janë pjesë të shkollave të mesme të bashkuara, që përfshijnë edhe ciklin e ulët të mesëm.

Shpërndarja e numrit të nxënësve në shkolla sipas njësive administrative tregon një variacion të dukshëm:

- Shkollat në njësitë me numër më të lartë nxënësish janë:
 - Maliq me 326 nxënës (shkolla “Agimi” dhe “Teki Kolaneci”), ku shkolla “Agimi” ka vetë 323 nxënës.
 - Vreshtas me 555 nxënës gjithsej, ku Podgoria ka numrin më të lartë (259 nxënës).
 - Pìrg me 536 nxënës, ku shkolla “Tafil Rexhepi” në Pìrg ka 241 nxënës.
 - Pojan me 660 nxënës, ku shkolla “Bardhyl Pojani” ka 188 nxënës dhe Zvezda 136 nxënës.
- Shkollat në njësitë me numër më të ulët nxënësish janë:
 - Gorë me 49 nxënës gjithsej, të shpërndarë në disa shkolla me regjistrime shumë të ulëta (deri në 1–3 nxënës).
 - Moglicë me 43 nxënës, shpërndarë në pesë institucione, disa prej të cilave kanë vetëm 1–2 nxënës.

Vëzhgime nga të dhënat:

- Balanca gjinore është relativisht e mirë në nivel bashkie, por ndryshon nga shkolla në shkollë.
- Ekzistojnë institucione me numër shumë të ulët nxënësish (p.sh. Peshtan me vetëm 1 nxënës, Velçan me 3 nxënës), çka sinjalizon sfida në eficiencën e rrjetit shkollor dhe nevojë për rishikim të organizimit.

- Zonat urbane dhe fshatrat me qendra të mëdha popullore kanë një përqendrim të dukshëm nxënësish, ndërsa zonat malore dhe të largëta kanë numër shumë të reduktuar regjistrimesh.

Frekuentimi në shkollat e arsimit të mesëm

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin e mesëm	Përqindja (%)
Djem	293	50.69
Vajza	285	49.31

Në nivelin e arsimit të mesëm në Bashkinë Maliq janë regjistruar gjithsej 578 nxënës, prej të cilëve 293 janë djem (50.69%) dhe 285 janë vajza (49.31%). Balanca gjinore është e afërt, me një diferencë të lehtë në favor të djemve.

Shpërndarja sipas shkollave:

- Shkolla “Skënderbeu”, Maliq ka numrin më të madh të nxënësve (174 gjithsej), duke përfaqësuar qendrën kryesore të arsimit të mesëm në bashki.
- Shkolla “Tafil Rexhepi”, Pirg ndjek me 154 nxënës, gjithashtu një nga pikat e rëndësishme të arsimit të mesëm në zonë.
- Shkolla “Nefail Rozani”, Podgorie ka 73 nxënës, ndërsa “Bardhul Pojani”, Pojan 62 nxënës dhe “Dhimitraq Gjata”, Rrëmbec 51 nxënës.
- Sheqeras dhe Lozhan i Ri kanë numrin më të ulët të nxënësve në këtë nivel (40 dhe 24 respektivisht), duke reflektuar kufizime të lidhura me madhësinë e komunitetit dhe zgjedhjet individuale për shkollimin.
- Pjesëmarrja gjinore është pothuajse e balancuar.
- Shumë prej shkollave kanë numër më të madh nxënësish në klasat e para të mesme (X dhe XI), ndërsa ka një rënie të lehtë në klasën e XII, çka mund të kërkojë vlerësim për mundësinë e braktisjes së shkollës ose orientim drejt arsimit profesional apo punësimit.
- Shkollat qendrore si Maliq dhe Pirg përbëjnë boshtin e ofrimit të arsimit të mesëm për një pjesë të madhe të territorit, duke tërhequr nxënës edhe nga zona të tjera.

4. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

Rrjeti i arsimit parauniversitar në Bashkinë Maliq mbulon të gjitha 7 njësitë administrative, duke përfshirë ciklin parashkollor, arsimin fillor, 9-vjeçar dhe të mesëm të përgjithshëm. Shpërndarja e institucioneve është projektuar për të garantuar akses të gjerë dhe të barabartë, por përmasat, numri i institucioneve dhe tipologjia e tyre ndryshojnë ndjeshëm nga njësi në njësi, në varësi të madhësisë së popullsisë, përqendrimit të vendbanimeve dhe karakteristikave gjeografike.

Megjithëse struktura dhe kapacitetet ndryshojnë nga një njësi në tjetrën, të gjitha zonat janë të pajisura me institucione që mundësojnë ndjekjen e vazhdueshme të arsimit deri në përfundim të shkollës së mesme.

Njësia Administrative Maliq

Njësia Administrative Maliq përbëhet nga qyteti i Maliqit dhe gjashtë fshatra, me një popullsi (sipas Gjendjes Civile) prej 7,595 banorësh, nga të cilët 3,780 janë femra dhe 3,815 meshkuj.

Shkollat:

Rrjeti arsimor përfshin 4 shkolla, 1 në ciklin fillor, 2 në ciklin 9-vjeçar dhe 1 shkollë të mesme, të vendosura strategjikisht për të siguruar akses të barabartë si në zonat qendrore ashtu edhe në ato periferike.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	Filllore F. Maliq	Fshat Maliq
2	"Agimi"	Maliq
3	"Teki Kolaneci"	Kolanec
4	"Skënderbeu"	Maliq

Kopshtet:

Për fëmijët e moshës 3–6 vjeç, funksionojnë 3 kopshte të vendosura në zona të ndryshme, duke ofruar edukim parashkollor cilësor dhe mbështetje për familjet.

Lista e kopshteve:

- Rreze Drite – Maliq
- Fshat Maliq
- Kolanec

Njësia Administrative Libonik

E përbërë (sipas Gjendjes Civile) nga 13 fshatra, Njësia Administrative Libonik ka 13,642 banorë (6,683 femra dhe 6,959 meshkuj).

Shkollat:

Funksionojnë gjithsej 7 shkolla, prej të cilave 4 janë në ciklin fillor dhe 3 në ciklin 9-vjeçar.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	Pocestë	Pocestë
2	Klocë	Klocë
3	"Hasan Latifi"	Drithas
4	Symiz	Symiz
5	"Muharrem Veizi"	Libonik
6	"3 Dëshmorët"	Vloçisht
7	Vashtëmi	Vashtëmi

Kopshtet:

Në territorin e saj funksionojnë 7 kopshte, të shpërndara në fshatrat kryesore.

Lista e kopshteve:

- Libonik – Libonik

- Vloçisht – Vloçisht
- Borëbardha – Drithas Poshtë
- Vashtëmi – Vashtëmi
- Pocestë – Pocestë
- Klocë – Klocë
- Symiz – Symiz

Njësia Administrative Gorë

Shkollat

Me 18 fshatra dhe 2,280 banorë (1,063 femra dhe 1,217 meshkuj) (sipas gjendjes Civile), Njësia Administrative Gorë ka një rrjet prej 9 shkollash: 4 në ciklin fillor, 4 në ciklin 9-vjeçar dhe 1 të mesme të bashkuar.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	Marjan	Marjan
2	Qënckë	Qënckë
3	Tresovë	Tresovë
4	Lozhan Fshat	Lozhan Fshat
5	Lozhan i Ri	Lozhan i Ri
6	Strelcë	Strelcë
7	Mesmal	Mesmal
8	Velçan	Velçan
9	Moçan	Moçan

Kopshtet

Në njësinë Gorë funksionojnë 5 kopshte në Lozhan i Ri, Lozhan Fshat, Strelcë, Mesmal dhe Desmirë.

Njësia Administrative Moglicë

Shkollat

Njësia Moglicë përbëhet nga 17 fshatra me 1050 banorë (462 femra dhe 588 meshkuj) (sipas gjendjes Civile).

Funksionojnë 5 shkolla 9-vjeçare të vendosura në fshatra të ndryshme.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	Moglicë	Moglicë
2	Peshtan	Peshtan
3	Popçisht	Popçisht
4	Kodras	Kodras
5	Zerec	Zerec

Kopshtet

Në territorin e saj ka 3 kopshte në Moglicë, Zerec dhe Popçisht.

Njësia Administrative Vreshtas

Shkollat

Njësia Vreshtas ka një rrjet prej 4 shkollash, ku 2 janë 9-vjeçare dhe 2 të mesme të bashkuara. Institucionet shtrihen në qendra të rëndësishme si Podgorie, Sheqeras, Vreshtas dhe Bregas.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	"Nefail Rozani"	Podgorie
2	Sheqeras	Sheqeras
3	"Myfit Mero"	Vreshtas
4	Bregas	Bregas

Kopshtet

Funksionojnë 5 kopshte në Vreshtas, Sheqeras, Bregas, Podgorie dhe Kopole.

Njësia Administrative Pirc

Shkollat

Me 11 fshatra dhe 10,021 banorë (4,835 femra dhe 5,186 meshkuj), Pirc ka 9 shkolla — 5 në ciklin fillor, 3 në ciklin 9-vjeçar dhe 1 të mesme të bashkuar.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	Navoselë	Navoselë
2	Leminot	Leminot
3	Kakaç	Kakaç
4	Gurishtë	Gurishtë
5	Velitërnë	Velitërnë
6	"Tafil Rexhepi"	Pirc
7	"Nevruz Vila"	Sovjan
8	Shqitas	Shqitas
9	"Misto Andoni"	Zvirinë

Ka gjithsej 9 kopshte të shpërndara në Pirc, Leminot, Velitërnë, Gurishtë, Shqitas, Kakaç, Sovjan, Novoselë dhe Zvirinë.

Njësia Administrative Pojan

Pojani përfshin 12 fshatra me një popullsi prej 16,665 banorësh (8,117 femra dhe 8,548 meshkuj). Rrjeti arsimor përbëhet nga 10 shkolla — 3 në ciklin fillor, 5 në ciklin 9-vjeçar dhe 2 të mesme të bashkuara.

Lista e shkollave:

Nr.	Shkolla	Fshat/Qytet
1	“Vangjel Viso”	Kreshpanj
2	“Nasi Simo”	Pendavinj
3	Burimas	Burimas
4	Gurbardhë	Gurbardhë
5	"Bardhyl Pojani"	Pojan
6	"Dhimitraq Gjata"	Rrëmbec
7	"Shaban Hoxha"	Plasë
8	Zvezdë	Zvezdë
9	Zëmlak	Zëmlak
10	"Neim Sertani"	Orman

Kopshtet

Në territorin e saj funksionojnë 11 kopshte në Pojan, Kreshpanj, Pendavinj, Zvezdë, Gurbardhë, Zëmlak, Rrëmbec, Tërovë, Plasë, Orman dhe Burimas.

5. Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse

Analiza e burimeve njerëzore edukative në Arsimin Parashkollor

Në territorin e Bashkisë Maliq funksionojnë 43 kopshte të shpërndara në të gjitha njësitë administrative, me një numër total prej 74 edukatorësh. Shpërndarja e stafit tregon diferenca të dukshme ndërmjet institucioneve, si në numrin e edukatorëve për kopsht, ashtu edhe në raportin me numrin e drejtorëve të kopshteve.

- Njësia Administrative Pojan ka densitetin më të lartë të institucioneve parashkollore, me 11 kopshte dhe gjithsej 17 edukatorë. Këtu përfshihet edhe një drejtues kopshti. Numri i edukatorëve varion nga 1 në disa kopshte të vogla si Kreshpanj, Pendavinj dhe Gurbardhë, deri në 3 edukatorë në kopshtin “Bardhyl Pojan”.
- Njësia Administrative Moglicë ka 3 kopshte me vetëm 3 edukatorë, duke treguar një raport të ulët stafi për institucion (mesatarisht 1 edukator për kopsht). Kjo tregon nevojë për forcim të burimeve njerëzore, sidomos në zona rurale me akses të vështirë.
- Njësia Administrative Vreshtas përfshin 5 kopshte me gjithsej 12 edukatorë. Kopshti me staf më të madh në këtë njësi është “Nefail Rozani” në Podgorie, me 4 edukatorë, ndërsa disa institucione kanë vetëm 1 edukator.
- Njësia Administrative Libonik ka 7 kopshte dhe 13 edukatorë, ku “Muharrem Veizi” në Libonik ka 3 edukatorë ku përfshihet dhe një drejtues kopshti. Shumica e kopshteve kanë 1 ose 3 edukatorë, me variacion të moderuar.
- Njësia Administrative Pirg përfshin 9 kopshte me 15 edukatorë. Stafi më i lartë është në “Tafil Rexhepi” me 3 edukatorë, ndërsa shumica e kopshteve kanë 1–2 edukatorë.
- Njësia Administrative Gorë ka 5 kopshte me gjithsej 5 edukatorë (1 edukator për çdo institucion), duke shënuar kapacitetin më të ulët në raport me numrin e fëmijëve potencialë.
- Njësia Administrative Maliq ka 3 kopshte me 9 edukatorë, ku bie në sy kopshti “Reze drite” me 7 edukatorë ku përfshihet dhe një drejtues kopshti, i cili është rikonstruktuar dhe ka potencial për zgjerim të shërbimeve, përfshirë ofrimin e vakteve ushqimore.

Drejtuesit e kopshteve janë gjithsej 3, të shpërndarë në Pojan, Libonik dhe Maliq, duke mbuluar kopshte kryesore me kapacitete të mëdha ose rol qendror në njësi.

Burimet njerëzore mbështetëse për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm

Bashkia Maliq ka një rrjet të gjerë institucionesh arsimore që mbështeten nga staf ndihmës i specializuar, i cili luan një rol kyç në funksionimin e përditshëm të shkollave dhe kopshteve. Ky staf përfshin pozicione si sanitare, roje, sekretarë dhe kaldaiste, të shpërndarë në të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

Në total janë të angazhuar 62 punonjës mbështetës, të cilët kontribuojnë në mirëmbajtjen e higjienës, sigurinë, administrimin dhe mirëfunksionimin teknik të godinave arsimore.

Struktura sipas pozicionit të punës:

- Sanitare: 50 punonjës, të shpërndarë në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë edhe kopshtin “Reze drite” në Maliq. Ky rol është esencial për ruajtjen e kushteve higjieno-sanitare në klasa, korridore, ambiente sanitare dhe hapësira të tjera.
- Roje: 4 punonjës, të cilët sigurojnë hyrje-daljet, mbikëqyrin mjediset shkollore dhe kontribuojnë në garantimin e një ambienti të sigurt për nxënësit dhe stafin.

- Sekretarë: 5 punonjës, që mbulojnë detyrat administrative, dokumentacionin, komunikimin me prindërit dhe institucionet, si dhe menaxhimin e regjistrave të nxënësve.
- Kaldaiste: 3 punonjës, të cilët kujdesen për sistemet e ngrohjes dhe mirëmbajtjen teknike të pajisjeve termike, sidomos gjatë periudhës së dimrit.

Shpërndarja sipas njësive administrative tregon një prani të balancuar të stafit në të gjitha zonat, përfshirë Pojan, Pirg, Maliq, Vreshtas, Moglicë, Libonik dhe Gorë, me një fokus të dukshëm në shkollat me numër më të madh nxënësish dhe nevoja më komplekse infrastrukturore.

Ky konfigurim i burimeve njerëzore mbështetëse siguron funksionimin e pandërprerë të proceseve mësimore dhe ruajtjen e standardeve të sigurisë, higjienës dhe administrimit, duke kontribuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit arsimor që ofrohet në Bashkinë Maliq.

6. Vizioni

Çdo fëmijë dhe nxënës në Bashkinë Maliq të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar në mjedise të sigurta, me kushte të mira dhe mbështetje të plotë nga shkolla, familja dhe komuniteti.



7. Qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar

Duke marrë në konsideratë analizat e deritanishme mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore, kapacitetet e burimeve njerëzore, boshllëqet në infrastrukturë dhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, Bashkia Maliq angazhohet të ndjekë këto qëllime dhe objektiva strategjike:

Qëllimi (Q1). Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve

- **Objektivi 1.1** Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit: *43 Kopshte; 48 Shkolla;*
- **Objektivi 1.2** Të përmirësohen kushtet e infrastrukturës dhe menaxhimit të arsimit parauniversitar dhe atij të mesëm në Bashkinë Maliq, përmes ndërtimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit të të paktën 3 institucioneve arsimore deri në fund të vitit 2028, si dhe krijimit dhe funksionalizimit të një regjistri digjital të të dhënave për të gjitha institucionet arsimore, me përditësim të rregullt vjetor.

Qëllimi (Q2) Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar.

- **Objektivi 2.1** Deri në fund të vitit 2028, Bashkia **Maliq**, në bashkëpunim me MASR dhe partnerët lokalë e ndërkombëtarë, të zhvillojë dhe zbatojë një program të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore në territorin e saj, duke realizuar të paktën 4 module trajnimi praktike çdo vit, me synim që **100% e edukatorëve** të aplikojnë metodologji bashkëkohore dhe mjete didaktike inovative në punën me fëmijët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e fëmijëve.
- **Objektivi 2.2** Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Qëllimi (Q3) Të garantohet një mjedis i sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Maliq, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete parandaluese, edukative, kulturore dhe sportive, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet ligjzbatuese, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, komunitetin dhe organizatat partnere, me synim forcimin e sigurisë, mirëqenies dhe përfshirjes sociale.

- **Objektivi 3.1** Deri në fund të vitit 2028, të rritet me të paktën 30% pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete parandaluese, edukative, kulturore dhe sportive në Bashkinë Maliq, duke zhvilluar të paktën 20 aktivitete vjetore në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe komunitetin, me qëllim forcimin e sigurisë, mirëqenies dhe përfshirjes sociale.

8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor

Plani financiar i parashikuar për periudhën 2025–2028 për arsimin bazë, duke përfshirë arsimin parashkollor, reflekton angazhimin e Bashkisë për të garantuar funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit arsimor në territorin e saj.

Në vitin 2025, buxheti total i planifikuar arrin në 149,317 mijë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë pagat, shpërblimet dhe shpenzimet e tjera të personelit (124,105 mijë lekë), ndjekur nga shpenzimet operative për mallra dhe shërbime të tjera (14,957 mijë lekë) dhe shpenzimet kapitale (10,255 mijë lekë).

Në vitin 2026, buxheti planifikohet të ulet në 131,655 mijë lekë, kryesisht si rezultat i reduktimit të shpenzimeve operative (500 mijë lekë) dhe atyre kapitale (7,000 mijë lekë), ndërsa shpenzimet e personelit mbeten pothuajse të pandryshuara (124,155 mijë lekë). Në vitin 2027, buxheti parashikohet të jetë 132,655 mijë lekë, me një rritje të lehtë në shpenzimet kapitale (8,000 mijë lekë), duke ruajtur nivelin edhe në vitin 2028.

Këto shifra tregojnë një fokus të qartë në mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe sigurimin e kushteve bazë funksionale të institucioneve arsimore, krahas investimeve të qëndrueshme për përmirësimin e infrastrukturës mësimore.

Aktivitetet	Viti 2025 (në mijë lekë)	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë
Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli	124,105	124,155	124,155	124,155
Shpenzime operative: Mallra dhe shërbime të tjera	14,957	500	500	500
Shpenzime kapitale	10,255	7,000	8,000	8,000
Totali	149,317	131,655	132,655	132,655

Arsimi i mesëm i përgjithshëm


Plani financiar i periudhës 2025–2028 për arsimin e mesëm të përgjithshëm synon të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit arsimor dhe të përmirësojë cilësinë e tij.

Në vitin 2025, buxheti total arrin në 21,244 mijë lekë, ku përfshihen pagat dhe shpenzimet e tjera të personelit (13,021 mijë lekë), shpenzimet operative për mallra dhe shërbime (1,837 mijë lekë) dhe shpenzimet kapitale (6,386 mijë lekë).

Në vitin 2026, buxheti parashikohet të rritet në 25,100 mijë lekë, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve kapitale (9,500 mijë lekë). Në vitin 2027 dhe 2028, buxheti do të arrijë përkatësisht në

26,200 dhe 26,500 mijë lekë, duke ruajtur një nivel të qëndrueshëm të shpenzimeve për personelin dhe një rritje të moderuar të shpenzimeve kapitale.

Aktivitetet	Viti 2025 (në mijë lekë)	Viti 2026 në mijë lekë	Viti 2027 në mijë lekë	Viti 2028 në mijë lekë
Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli	13,021	13,100	13,200	13,500
Shpenzime operative: Mallra dhe shërbime të tjera	1,837	2,500	3,000	3,000
Shpenzime kapitale	6,386	9,500	10,000	10,000
Totali	21,244	25,100	26,200	26,500



9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

Objektivi specifik O1.1 Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit: 43 Kopshte; 48 Shkolla;

Aktivite	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Sigurimi i stafit të nevojshëm arsimor dhe të punonjësve të shërbimeve mbështetëse për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm <i>Ky aktivitet ka për qëllim të garantojë plotësimin e nevojave për personel mësimor dhe ndihmës në të gjitha institucionet arsimore, duke përfshirë:</i> • 43 Kopshte • 48 Shkolla • 74 Staf edukator • 62 Staf mbështetës (gjithsej)	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	<i>Numri i kopshteve të mbështetura me staf edukativ dhe mbështetës;</i> <i>Numri i personelit edukativ në arsimin parashkollor;</i> <i>Numri i stafit për shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore parashkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.);</i> <i>Raporti i mësuesve ndihmës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte</i> <i>Numri i fëmijëve egjiptianë të regjistruar në kopshte;</i> <i>Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjiptian të regjistruar në kopshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm;</i> <i>Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla;</i>

					<i>Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjyptian të regjistruar; (që frekuentojne) në shkolla;</i> <i>Raporti edukator për fëmijë në kopsht;</i> <i>Numri mesatar i fëmijëve për grup;</i> <i>Numri mesatar i fëmijëve për grup në parashkollor (klasa pergatitore);</i> <i>Numri i shkollave të mbështetura me staf mbështetës;</i> <i>Numri i stafit mbështetës në institucionet arsimore shkollore (roje, pastrues; ndihmës teknikë, etj.);</i> <i>Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin bazë;</i> <i>Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e mesëm;</i> <i>Shpenzime për shërbime mbështetëse për nxënës (në mijë lekë);</i>
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore <i>Për të siguruar kushte të përshtatshme mësimi dhe zhvillimi për fëmijët dhe nxënësit, do të realizohen ndërhyrje për riparime, rikonstruksione të pjesshme dhe investime të tjera të vogla infrastrukturore. Këto ndërhyrje do të fokusohen në përmirësimin e godinave ekzistuese, ambienteve të brendshme, sistemeve të ndriçimit dhe mobilimit, duke përfshirë</i> • 43 Kopshte	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Numri godinave të arsimit (parashkollor, 9- vjeçar, i mesëm) ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes;

• 48 Shkolla					
Sigurimi i furnizimit dhe shërbimit me ujë të pijshëm dhe ener;gjii elektrike për të gjitha institucionet arsimore: • 43 Kopshte • 48 Shkolla	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm; Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me energji elektrike;
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare <i>Do të sigurohen materiale dhe pajisje për mirëmbajtjen e higjienës, si dhe shërbime pastrimi të rregullta për të gjitha institucionet arsimore. Aktiviteti synon të mbajë ambientet e kopshteve dhe shkollave të pastra dhe të sigurta për shëndetin e fëmijëve dhe stafit. Ky aktivitet përfshin:</i> • 43 Kopshte • 48 Shkolla	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore <i>Kjo përfshin mirëmbajtjen e infrastrukturës së ngrohjes, dhe sigurimin e karburantit apo</i>	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem të sigurtë dhe funksional ngrohjeje

burimeve të tjera energjie për funksionimin e tyre. Aktiviteti mbulon , duke përfshirë: • 43 Kopshte • 48 Shkolla					
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore <i>Për të mundësuar zhvillimin normal të procesit mësimor dhe administrativ, do të sigurohen furnizime të vazhdueshme me materialet e nevojshme kancelarike, duke përfshirë:</i> • 43 Kopshte • 48 Shkolla	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit <i>Do të realizohet furnizimi dhe instalimi i fikseve të zjarrit në të gjitha institucionet arsimore, si dhe kontrolli periodik i funksionalitetit të tyre dhe kolaudimi sipas standardeve të sigurisë. Ky aktivitet përfshin:</i> • 43 Kopshte • 48 Shkolla	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale; Nr. i kopshteve dhe shkollave me fikse zjarri funksionale;
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion administrativ

• 43 Kopshte • 48 Shkolla					
Ofrimi i shërbimit të vakteve ushqimore në institucionet e arsimit parashkollor <i>Sigurimi i ushqimit të shëndetshëm dhe të balancuar për fëmijët e moshës 3–6 vjeç në tërësi në institucionet parashkollor në administratën e Malit.</i>	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i kopshteve me ushqim; Nr. i fëmijëve që përfitojnë nga shërbimi i vakteve ushqimore në kopsht;
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore Për të parandaluar përhapjen e infeksioneve dhe për të garantuar një ambient të shëndetshëm, do të kryhen dezinfektimet periodike në të gjitha institucionet e arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky aktivitet përfshin: • 43 Kopshte • 48 Shkolla	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i kopshteve dhe shkollave për të cilat kryhet shërbimi i dezinfektimit;

Objektivi specifik O1.2 Të përmirësohen kushtet e infrastrukturës dhe menaxhimit të arsimit parauniversitar dhe atij të mesëm në Bashkinë Maliq, përmes ndërtimit, rikonstruksionit dhe rehabilitimit të të paktën 3 institucioneve arsimore deri në fund të vitit 2028, si dhe krijimit dhe funksionalizimit të një regjistri digjital të të dhënave për të gjitha institucionet arsimore, me përditësim të rregullt vjetor.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Ndërhyrje kapitale në shkollat e mesme dhe ato 9-vjeçare për të garantuar kushte të sigurta dhe të përshtatshme mësimore — Rikonstruksion Shkolla e Mesme Maliq — Ndërtim Shkolla 9-vjeçare Zvirinë — Ndërtim shkolla CU Fshati Maliq	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruktura; Rikonstruksioni dhe përmirësimi i standardeve të të paktën 3 shkollave); Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në shkolla;
Rehabilitimin e objekteve shkollore për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet higjieno-sanitare. — Rehabilitim objekte shkollore	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rehabilituara (Rehabilitimi dhe përmirësimi i standardeve të institucioneve arsimore); Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në kopshte;
Ndërhyrje kapitale në arsimin parashkollor — Ndërtimi i një kopshti të ri në Libonik, Sheqeras	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruktura; Përmirësim i standarteve të infrastrukturës në kopshte;
Zhvillimi dhe ndërtimi i një regjistri të dhënash digjitale për institucionet arsimore Krijimi i një regjistri të centralizuar elektronik që mbledh, ruan të dhënat për	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/s hkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë),	Krijimi dhe funksionalizimi i regjistrit digjital të të dhënave për arsimin parauniversitar dhe atë të mesëm, me përditësim të rregullt vjetor.

<i>kopshtet dhe shkollat, duke mundësuar menaxhim më efikas të informacionit mbi infrastrukturën, stafin, numrin e fëmijëve/nxënësve, nevojat për investime dhe shërbimet mbështetëse.</i>					
--	--	--	--	--	--

Qëllimi 2 (Q2) – Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t’u rritur dhe për t’u zhvilluar.

Objektivi specifik O2.1 Deri në fund të vitit 2028, Bashkia Maliq, në bashkëpunim me MASR dhe partnerët lokalë e ndërkombëtarë, të zhvillojë dhe zbatojë një program të vazhdueshëm trajnimi për të gjithë edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore në territorin e saj, duke realizuar të paktën 4 module trajnimi praktike çdo vit, me synim që 100% e edukatorëve të aplikojnë metodologji bashkëkohore dhe mjete didaktike inovative në punën me fëmijët, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e fëmijëve.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Zhvillimi i një programi të vazhdueshëm trajnimi për edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore, me fokus në përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative. Aktiviteti do të përfshijë: <i>Organizimin e sesioneve praktike dhe workshopeve mbi mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës;</i> <i>Përdorimin e materialeve moderne edukative për të nxitur kreativitetin, zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve;</i> <i>Forcimin e aftësive për vlerësimin e ecursë individuale të fëmijës dhe përshtatjen e programeve sipas nevojave të tij;</i> <i>Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet institucioneve brenda dhe jashtë bashkisë.</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MASR, institucionet arsimore, OSHC, ASKAP	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. i edukatorëve të trajnuara; Nr. i kopshteve/fëmijëve që kanë përfituar nga praktika të përmirësuara të mësimdhënies;

Objektivi specifik O2.2 Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese dhe këshilluese në institucionet arsimore <i>Krijimi dhe fuqizimi i strukturave të përfaqësimit dhe këshillimit në kopshte dhe shkolla, duke përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit. Aktiviteti synon rritjen e transparencës, përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet stafit arsimor, prindërve dhe komunitetit.</i>	2025–2026	Njësia për Arsimin, Drejtuesit e IA	Prindër, komuniteti lokal	Buxhet vendor	Nr. institucioneve me struktura funksionale • 15 Kopshte • 20 Shkolla
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte <i>Sigurimi i një shërbimi psiko-social të rregullt dhe të specializuar për fëmijët e moshës parashkollore, në partneritet me zyrën e shërbimit social të bashkisë dhe ZVA -psikologët që punojnë në shkolla. Ky shërbim do të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e vështirësive emocionale, sociale apo zhvillimore të fëmijëve.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin, Zyra e Shërbimit Social	OSHC, specialistë të licencuar	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. kopshte me shërbim psiko-social aktiv (15 Kopshte) Nr. i personelit të dedikuar për shërbimin psikosocial në kopshte
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2025–2028	Njësia për Arsimin	Drejtuesit e shkollave dhe kopshteve,	Buxhet vendor, financim donatorësh	Numri i nxënësve/fëmijëve përfitues

<i>Zbatimi i programeve ndihmëse për fëmijët dhe nxënësit që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike , duke përfshirë ofrimin e pajisjeve shkollore, transportit, ushqimit apo shërbimeve të tjera që lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në arsim.</i>			Organizata të Shoqërisë Civile		Numri i nxënësve/fëmijëve rom dhe egjiptianë Numri i nxënësve/fëmijëve në ndihmë ekonomike Numri i nxënësve/fëmijëve me një prind; Etj.
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera <i>Vlerësimi dhe motivimi i nxënësve me arritje të larta akademike përmes bursave, shpërblimeve apo mundësive për pjesëmarrje në konkurse kombëtare, me synim nxitjen e ekselencës dhe talentit të ri.</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur

Qëllimi 3 (Q3)– Të garantohet një mjedis i sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Maliq, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete parandaluese, edukative, kulturore dhe sportive, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet ligjzbatuese, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, komunitetin dhe organizatat partnere, me synim forcimin e sigurisë, mirëqenies dhe përfshirjes sociale.

Objektivi specifik O3.1 Deri në fund të vitit 2028, të rritet me të paktën 30% pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete parandaluese, edukative, kulturore dhe sportive në Bashkinë Maliq, duke zhvilluar të paktën 20 aktivitete vjetore në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe komunitetin, me qëllim forcimin e sigurisë, mirëqenies dhe përfshirjes sociale.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Në kuadër të garantimit të një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët dhe të rinjtë, Bashkia Maliq, në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, planifikon zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme: Bashkëpunim me Policinë e Shtetit për: — Organizimin e sesioneve informuese në shkollë mbi sigurinë personale dhe në komunitet; — Trajnimin e stafit edukativ dhe nxënësve mbi reagimin në situata emergjente. Fushata ndërgjegjësimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore: — Aktivitetet do të zhvillohen në partneritet me organizata të specializuara dhe policinë, duke u fokusuar te parandalimi,	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, Drejtoria e Sherbimit Social; Policia e shtetit; OJQ, MAS Prinderit	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të Shoqërisë Civile.	Siguria në shkollë dhe komunitet • Numri i sesioneve informuese mbi sigurinë personale dhe në komunitet të zhvilluara në shkollë • Numri i stafit edukativ dhe nxënësve të trajnuar për reagimin në situata emergjente Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore • Numri i fushatave ndërgjegjësuere kundër trafikimit të realizuara • Numri i pjesëmarrësve në fushatat kundër trafikimit

<i>informimi dhe raportimi i rasteve të dyshimta.</i> Program për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare: — <i>Workshope dhe diskutime me prindër, nxënës dhe mësues mbi format e dhunës dhe mekanizmat e raportimit;</i> — <i>Promovimi i marrëdhënieve të shëndetshme familjare dhe komunikimit pozitiv.</i> Nisma kundër bullizmit në institucionet arsimore: — <i>Zhvillimi i orëve edukative dhe aktiviteteve praktike mbi empatinë, respektin dhe menaxhimin paqësor të konflikteve;</i> — <i>Krijimi i një mekanizmi të brendshëm raportimi në çdo shkollë.</i> Fushata kundër shfrytëzimit të punës së fëmijëve: — <i>Në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve, organizimi i takimeve me prindër, komunitetin dhe bizneset për të parandaluar përfshirjen e fëmijëve në punë të rrezikshme ose që pengojnë ndjekjen e shkollës;</i>					Parandalimi i dhunës në marrëdhëniet familjare • Numri i workshopeve dhe diskutimeve me prindër, nxënës dhe mësues • Përqindja e pjesëmarrësve që raportojnë rritje të njohurive mbi format e dhunës dhe mekanizmat e raportimit Parandalimi i bullizmit • Numri i orëve edukative dhe aktiviteteve praktike kundër bullizmit të zhvilluara • Numri i shkollave që kanë mekanizëm të brendshëm raportimi për bullizmin Parandalimi i shfrytëzimit të punës së fëmijëve • Numri i takimeve me prindër, komunitetin dhe bizneset për parandalimin e punës së fëmijëve • Numri i rasteve të identifikuara dhe të referuara të punës së fëmijëve
--	--	--	--	--	---

Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit. (Bashkia mbështet aktivitetet jashtëshkollore të organizuara nga institucionet arsimore të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë për vitin shkollor, i cili miratohet për çdo vit.) ¹	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të Shoqërisë Civile, Qendra Kulturore të fëmijëve“Nimet e Progonati”	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
Aktivitetet e sugjeruara për kopshtet dhe shkollat, në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë					
23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit — Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore) — Ushtrime në natyrë (gimnastikë) — Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Prill–Maj – Java Olimpikë — Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa) — Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe — Gara me biçikleta	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
20 Nëntor – Dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve — Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

¹ Mbështetja me fonde të sigurohet edhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 11, datë 27.5.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë. Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për menaxhimin e buxheteve të shkollave. Ai siguron që menaxhimi i fondeve buxhetore të jetë transparent dhe në përputhje me ligjet në fuqi, duke ndihmuar shkollat të menaxhojnë më mirë shpenzimet e tyre. Roli i Bashkisë është përcaktuar si aktor që vë fonde në dispozicion, si dhe lidhet edhe me proceset inventarizuese apo asistencë për zhvillim procedurash.

— Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia” — "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)					
Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor) — Bisedë me fëmijët					
Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe — Postera me gjuhën shqipe & ilustrime — Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor) — Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta — Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta) — Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Botërore e Gjuhës Amtare — Vizitë në bibliotekë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) — Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) — “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra) — Bisedë për vlerat e ujit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Ndërkombëtare e Romëve — Bisedë për fëmijët romë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

Zakonet dhe traditat e romëve	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Botërore e Librit (23 prill) — Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues) — Vizitë në bibliotekë — Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor) — Ekspozitë me mjete të riciklueshme — Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt) — Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik) — Mbajmë pastër mjedisin ku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë) — Ekskursion në lulishten e qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Pedalo për Turizëm dhe Kulturë — Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit — Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Yjet e Vallzimit në bashkëpunim me QKF — Konkurs midis kopshteve të qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
Pedalo Kuq e në bashkëpunim me QKF — Marshim me biçikleta të fëmijëve të kopshtit me rastin e Festave Kombëtare	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

10. Plani i investimeve kapitale

Plani i investimeve kapitale për arsimin parauniversitar dhe të mesëm të përgjithshëm në Bashkinë Maliq për periudhën 2026–2028 synon të garantojë kushte të qëndrueshme, funksionale dhe bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit në territorin e bashkisë.

Ky plan fokusohet në ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve arsimore, rehabilitimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e hapësirave të reja, duke synuar rritjen e cilësisë së mjediseve mësimore dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë nxënësit dhe fëmijët e moshës parashkollore.

Prioritetet kryesore të investimeve përfshijnë:


- Ndërhyrje kapitale në shkollat e mesme dhe ato 9-vjeçare për të garantuar kushte të sigurta dhe të përshtatshme mësimore.
- Rehabilitimin e objekteve shkollore për të përmirësuar infrastrukturën dhe kushtet higjieno-sanitare.
- Ndërtimin e ambienteve të reja për arsimin parashkollor dhe bazë, duke iu përgjigjur rritjes së kërkesës për këto shërbime.

Planifikimi i investimeve për arsimin bazë dhe të mesëm (2026–2028, në mijë lekë)

Nr.	Investimi i planifikuar	2026	2027	2028	Totali
2	Rikonstruktion Shkolla e Mesme Maliq	–	–	–	148,472
3	Rehabilitim objekte shkollore	7,000	8,000	8,000	23,000
Totali		7,000	8,000	8,000	171,472

00000000000000000000Planifikimi i investimeve për arsimin parashkollor (2026–2028, në mijë lekë)

Nr.	Investimi i planifikuar	2026	2027	2028	Totali
2	Ndërtimi i një kopshti të ri në Libonik, Sheqeras	–	–	–	40,000
3	Ndërtim Shkolla 9-vjeçare Zvirinë	–	–	–	51,319
4	Ndërtim shkolla CU Fshati Maliq	–	–	–	27,617
5	Rehabilitim objekte shkollore	25,100	26,200	26,500	77,800
Totali		25,100	26,200	26,500	196,736



Totali i investimeve për periudhën 2026–2028 arrin në **368,208 mijë lekë**, duke reflektuar angazhimin e Bashkisë Maliq për të investuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve mësimore si bazë për një shërbim arsimor cilësor, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Treguesit e performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktiviteteve në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Pike maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet 0.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

11. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Maliq. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Maliq.

12. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

13. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar 0

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore